FTESË PËR OFERTË

–Vazhdim i licencave për pajisje të teknologjisë informative – Forti Analyzer –

Ref. RFO-046-11-2026

I. **Autoriteti kontraktues:** Banka për Biznes Sh. A.

II. **Lënda e kontratës:** "Vazhdim i licencave për pajisje të teknologjisë informative – Forti Analyzer"

III. **Procedura e përdorur:** E hapur

IV. **Kushtet e ofertimit:**

a) Afati kohor dhe vendi i dërgimit të ofertave:
- Afati i fundit për dërgimin e ofertës është data **18 nëntor 2026** deri në ora **15:00**
- Oferta duhet të dërgohet në formë elektronike në email adresën prokurimi@bpbbank.com

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dërgoj dokumentacionin e nevojshëm ligjor – Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit, Çertifikatën e TVSH-së dhe Çertifikatën e Numrit Fiskal.
- Banka për Biznes është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarësi vlerën e TVSH-së. ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqesë referencat e saja për shërbime të ngjashme.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dërgimit.
- Oferta duhet të dërgohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anuloj tenderin dhe/ose të ndryshoj karakteristikat e tenderit dhe t'i ftoj sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **12 nëntor 2026** në email adresën prokurimi@bpbbank.com dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-15:00.